Gjatë viteve 1944-1990 Shqipëria ishte një sistem politik njëpartiak, stalinist dhe unik në mënyrën agresive të ushtrimit të pushtetit. Ai Ishte vendi i vetëm refuzues i procesit të Helsinkit dhe me Kushtetutë, i ndalimit të besimit në Zot. Konceptet e të drejtave të njeriut *de facto* ishin dhe mbetën të huaja, të rrezikshme dhe të ndëshkueshme me ligj. Me pushtete të njësuara nën pushtetin suprem të PPSH, regjimi ia doli për 46 vjet të krijojë një kulturë nënshtrimi strukturor dhe ideologjik të ushqyer përmes propagandës, dhunës dhe frikësimit... Çdo libër që përshkruan jetën nën këto regjime, që tregon kontrollin total, censurën, paranojën, policinë sekrete, kampet e përqendrimit, kampet e punës, zhvendosjet dhe ekzekutimet; çdo libër që nxjerr në shesh kultet e personalitetit që i fuqizojnë këto regjime, - çdo vepër e tillë është një thesar. Ky libër rrëfen tiparet, ideologjinë dhe praktikat e Shqipërisë komuniste ndaj duhet të lexohet jo vetëm nga politologët, historianët dhe studentët e tyre, por nga çdo qytetar, në mënyrë që ne të mos t'u rikthehemi tmerreve të së shkuarës.

Botimi është kontribut profesional i disa studiuesve dhe përmbledh fusha e këndvështrime të ndryshme mbi shtetin e shoqërinë gjatë periudhës 1945-1990 në Shqipëri. Botimi u mbështet nga programi TRANSITION i MPJ të Republikës së Çekisë.

ISBN 978-9928-4592-8-2

EDITORË - *Afrim KRASNIQI, Věra STOJAROVÁ*

SHTETI DHE SHOQËRIA NË SHQIPËRINË KOMUNISTE 1945-1990

EDITORË
Afrim KRASNIQI
Věra STOJAROVÁ

SHTETI DHE SHOQËRIA NË SHQIPËRINË KOMUNISTE 1945-1990

ISP
Instituti i Studimeve Politike
www.isp.com.al

TRANSITION
Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic

Embassy of the Czech Republic
in Tirana

SISTEMI QEVERISËS DHE ASPEKTE TË PËRFAQËSIMIT POLITIK 1945-1990

Afrim KRASNIQI*

Gjatë periudhës 1945-1990 zyrtarisht Shqipëria ishte republikë parlamentare, por me formën e demokracive popullore dhe sistemit njëpartiak, i njëjtë për të gjitha vendet e bllokut komunist në Europën Lindore. Vendimi nuk ishte produkt i një referendumi, por i Kongresit të Përmetit (1944) dhe më pas i ratifikuar indirekt nga Asamblesë Kombëtare më 1946, me rastin e votimit të Kushtetutës së RPSH. Sistemi i ri qeverisës u vendos duke ndaluar monarkinë dhe përfaqësuesit e kurorës mbretërore dhe duke vendosur sistemin politik njëpartiak, i njohur si sistemi i partisë-shtet. Shqipëria ishte pjesë e një procesi politik në të gjithë sferën e ndikimit sovjetik, ndaj vendimi për sistemin, formën, përmbajtjen dhe dokumentet kryesore legjitimues të tij ishin produkt i ndikimeve dhe konsultimeve me fuqinë e jashtme dominuese, fillimisht Jugosllavia dhe më pas BRSS.

Në 46 vjet u miratuan në Asamble/Kuvend dy kushtetuta, Kushtetuta e RP të Shqipërisë 1946-1976 dhe ajo e RPSSH 1976-1990. Kushtetuta e vitit 1946 nuk ka dallime nga modelet e njëjta të vendeve ish-komuniste dhe në tërësinë e saj imiton terma dhe nene të njëjta të

*Afrim Krasniqi (1971). Diplomuar në FHF në Universitetin e Tiranës, ka kryer studimet master në Universitetin Evropian Viadrina (Frankfurt–Oder), Gjermani dhe ka doktoraturë në Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në UT (FHF) (2012). Ka titullin akademik Profesor i Asociuar (2015). Është lektor në shkencat politike dhe histori në Universitetin e Tiranës (nga 2004), Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Studimeve Politike (nga 2014), kërkues shkencor në Akademinë e Studimeve Albanologjike (nga 2017). Është autor i një numri të konsiderueshëm monografish, studimesh dhe artikujsh shkencor brenda dhe jashtë Shqipërisë.

kushtetutës jugosllave, kryesisht për shkak të asistencës që iu ofrua nga ekspertët e tyre regjimit të Tiranës. Kushtetuta e vitit 1946 sanksionoi vendosjen e regjimit komunist dhe i dha fund periudhës kalimtare (1944-1945) lidhur me legjitimitetin e pushtetit dhe aplikimit të gjendjes së luftës. Kushtetuta e vitit 1976, megjithëse kishte të njëjtat parime e qëllime, shpreh një realitet tjetër të Shqipërisë së asaj periudhe. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë (1948), me BRSS (vitet '60), daljes nga Traktati i Varshavës (1968), si dhe me Kinën (mesi i viteve '70) Shqipëria vendosi të ndjekë një rrugë tjetër, të vetme dhe unikale. Ajo vendosi izolimin e plotë, ecjen sipas parimit "me forcat e veta", duke tentuar të ndërtojë një lloj të veçantë socializmi, shumë më fanatik dhe konservator se format e aplikuara deri atëherë edhe në vendet e tjera të Europës Lindore. Ajo refuzoi reformat liberalizuese që ndodhën në disa vende ish-komuniste, si dhe ndryshe nga vetë Bashkimi Sovjetik, shpalli besnikërinë ndaj trashëgimisë ideologjike e politike të Stalinit. Më 1976-77-ën në Poloni e Hungari dolën në pah grupe liberale si "Karta 77" apo "Solidarnos", një figurë fetare polake mori drejtimin e Kishës Katolike në botë, ndërsa në Shqipëri u miratua Kushtetuta e re, e cila i shpalli luftë besimit në Zot dhe çdo forme liberalizimi.

Në dallim nga qëllimi i legjitimimit të pushtetit më 1946, qëllimi kryesor i Kushtetutës së vitit 1976 ishte garantimi i paprekshmërisë së pushtetit, refuzimi i çdo forme ndryshimi dhe sigurimi i trashëgimisë politike të PPSH. Midis 1945-1976 pushteti popullor dhe PPSH kishin qenë forca e vetme udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë, por më 1976 kjo trashëgimi u sanksionua në Kushtetutë. Neni 3 mbetet unikal në të gjitha vendet e lindjes komuniste, pasi një nen kushtetues fut për herë të parë partinë – shtet, PPSH-ja si *"forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë"*[26]. Roli udhëheqës i partisë u forcua edhe me nene të tjera, por sidomos me nenin 67, në të cilin theksohej se Kuvendi Popullor, *"përcakton në përputhje me vijën e përgjithshme dhe direktivat e PPSH-së drejtimet kryesore të politikës së brendshme dhe të jashtme"*; pra shprehimisht sanksionoi

[26] *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.*

që direktivat e partisë të ktheheshin në vendime të Kuvendit Popullor[27]. Kushtetuta e re gjithashtu e avancoi modelin e vet socialist, duke përcaktuar se *"ideologjia sunduese është marksizëm-leninizmi"* dhe vetëm në bazë të këtyre parimeve *"zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist"*. Në Kushtetutën e re RPSSH-ja shpallej *"shtet i diktaturës së proletariatit" që "mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ka në themel aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore"*[28]. Një tipar tjetër i kushtetutës së re është fakti se ajo shpallte parimin e unitetit të pushtetit[29] krejt të kundërt me parimin demokratik të ndarjes dhe balancës së pushteteve. Në nenin 55 të Kushtetutës thuhet: *"ndalohet krijimi i çfarëdo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist" dhe, për pasojë, edhe çdo veprimtari e mendim ndryshe nga ai i PPSH-së.* Të tre këto nene praktikisht sanksionojnë realitetin politik të viteve 1946-1976, aplikimin e modelit të partisë – shtet. Të gjitha pushtetet kushtetuese ishin në varësi të partisë, të kontrolluara e të zgjedhura prej saj dhe për rrjedhojë, edhe axhenda e tyre politike e ligjore, përcaktohej nga partia. Nëse përpara vitit 1976 kritika ndaj partisë konsiderohej krim shtetëror, tashmë kjo sanksionohej me kushtetutë në nivelin më të lartë legjislativ të një shteti[30].

Kushtetuta e re mori angazhimin për thellimin e luftës së klasave dhe ecjen në rrugën tashmë unikale të ndërtimit të plotë "të socializmit e të komunizmit". Ashtu si në kushtetutën e vitit 1946, edhe më 1976-ën regjimi konsideronte si klasë besnike të tij klasën punëtore, fshatarësinë dhe punonjësit e tjerë, duke mos përmendur në asnjë rast inteligjencën dhe rininë, dy kategori më të distancuara nga propaganda e regjimit. Neni 7 përfshiu në Kushtetutë edhe detyrimin që çdo organ shtetëror të mbështetej në punën e tij në *"iniciativën krijuese të masave punonjëse"*, një koncept populist dhe ideologjik i kundërt me teorinë e shtetit. Me këto prioritete dhe me mbështetje fanatike tek PPSH-ja, regjimi shprehu

---

[27] Luan Omari. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.
[28] Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.
[29] Luan Omari. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.
[30] Krasniqi, Afrim. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.

bindjen për arritjen e qëllimit madhor, *"për të kaluar pastaj gradualisht në shoqërinë komuniste"*. Pra, nëse më 1946-ën synohej një Shqipëri socialiste dhe ndërtimi i socializmit, 30 vjet më vonë kjo merrej e arritur dhe synimi i adresohej shoqërisë komuniste *"si forma më e lartë e socializmit"*.

Kushtetuta e re, përcaktonte se tipar kryesor i organizimit të shtetit komunist ishte modeli i centralizuar i pushtetit. Kushtetua e thekson këtë parim si parim udhëheqës, që duhej *"kombinuar me iniciativën krijuese të organeve lokale dhe të masave punonjëse në luftë kundër burokratizmit e liberalizimit"*. Më tej, ajo sanksionon parimin e mbështetjes në forcat e veta dhe thekson se tregtia e jashtme është monopol i shtetit. Pika kulmore e politikave vetizoluese në ekonomi është përcaktimi i nenit 28, sipas të cilit *"ndalohet dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike e financiare e të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe me shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si edhe marrja e kredive prej tyre"*. Nën pretekstin e këtij neni Shqipëria refuzoi vazhdimisht marrjen e ndihmës ekonomike gjermane në vitet 1984-1986, ashtu edhe ofertat e tjera të bashkëpunimit dhe të ndihmës ekonomike që erdhën nga shtete të ndryshme evropiane[31].

Në përcaktimin e rendit ekonomik, Kushtetuta e re bën dallim të madh me kushtetutën e vitit 1946. Nëse kjo e fundit lejonte përdorimin dhe ekzistencën e bashkëjetesën e pronës së kufizuar private, Kushtetuta e vitit 1976 ishte kategorike kundër çdo lloji të formës private. Ajo theksonte parimin politik se RPSSH-ja zhvillon një ekonomi socialiste të mbështetur në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit. E vetmja pronë private që njihet nga kushtetuta e re janë *"të ardhurat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpia e banimit dhe sende të tjera që shërbejnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare"*. Angazhimi më i rëndësishëm kushtetues në fushën e kulturës dhe të edukimit është ai i *"një veprimtarie të gjerë ideologjike e kulturore për edukimin komunist të punonjësve, për formimin e njeriut të ri"*, si dhe kujdesi i veçantë *"për zhvillimin dhe edukimin e gjithanshëm të brezit të ri në frymën e socializmit e të komunizmit"*. Edhe kur flitej për

---

[31] Krasniqi, Afrim. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.

kulturën theksohej se shteti *"përkrah zhvillimin e letërsisë dhe të artit të realizimit socialist që i përmbahet idealeve të socializmit e të komunizmit dhe përshkohet nga fryma kombëtare e popullore"*. Në përcaktimin e aspekteve të ndryshme të organizimit dhe jetës shoqërore, siç ishin institucioni i martesës, i marrëdhënieve familjare, etj., në dallim nga kushtetuta e vitit 1946 u hoqën të gjitha referimet e mundshme në praktikat fetare dhe traditën e vjetër.

Sipas vetë ekspertëve teknikë[32] të Kushtetutës së vitit 1976, *"të drejtat dhe liria demokratike themelore që shpalleshin, ndonëse me mjaft kufizime, ishin krejt formale përderisa sanksionohej diktatura e proletariatit dhe roli udhëheqës absolut i partisë dhe nuk lejohej shprehimisht asnjë parti tjetër politike; për më tepër, sikurse dihet, u eliminua krejt prona private, pra, në këtë aspekt u bë një reformë radikale që nuk ishte njohur në asnjë nga vendet e tjera socialiste dhe veçanërisht u ndaluan kultet fetare, të lira deri në v. 1967, ndonëse me kufizime; kurse në vende të tjera, edhe në Bashkimin Sovjetik, këto kulte nuk u eliminuan, por u lejuan; me kufizime, me persekutime, ama u lejuan. Tek ne ato u eliminuan totalisht"*[33].

Institucionet formale të sistemit të ri

Kushtetuta e re u kalua përmes së njëjtës procedurë si ajo e vitit 1946. Një komision politik shtetëror, i përbërë nga të gjithë drejtuesit e shtetit, kryetar kishte Sekretarin e Parë të KQ-së të PPSH-së, Enver Hoxhën dhe jo kryeministrin apo kryetarin e presidiumit të Kuvendit Popullor. Në funksion të tij pati edhe një grup juristësh dhe ekspertësh që u emëruan nga qeveria për të përpunuar një draft paraprak, i cili kaloi më pas për debat publik në strukturat e PPSH-së dhe të shtetit komunist. Pas një fushate aktive propagandistike të regjimit në favor të kushtetutës dhe arritjeve të saj, më 28 nëntor, në Ditën e Pavarësisë, u deklarua miratimi dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës së re shqiptare. Tipar i rëndësishëm i Kushtetutave 1946 dhe 1976 ishte eliminimi nga normat kushtetuese i parimit të ndarjes së pushteteve dhe për rrjedhojë, edhe i ndarjes së

[32] *Luan Omari. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.*
[33] *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.*

funksioneve legjislative apo ekzekutive, me pushtetet e tjera[34]. Nëse në parlamentet e mëparshme një deputet, një anëtar i Këshillit të Lartë apo një senator nuk mund të kishte njëherësh angazhime të tjera zyrtare, në pushtetet e tjera dhe sidomos në sektorin administrativ të shtetit, në sistemin e ri të krijuar pas 1944-ën këto kufizime hiqeshin tërësisht.

Në sistemin e ri politik Presidiumi i Kuvendit Popullor, Kuvendi dhe qeveria ishin institucionet kryesore. Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (1985) Kuvendi Popullor është organi më i lartë i pushtetit shtetëror, mbajtës i sovranitetit të popullit e të shtetit, dhe i vetmi organ ligjvënës që nga viti 1946, kur përfundoi detyrën e vet Asambleja Kushtetuese[35]. Në përgjegjësitë e parlamentit, në dallim nga modeli i vitit 1946 ishte shtuar kompetenca[36] *"në përputhje me vijën e përgjithshme dhe direktivat e Partisë së Punës së Shqipërisë, drejtimet kryesore të politikës së brendshme e të jashtme të shtetit"*. Kuvendi formalisht konsiderohej[37] *"organi më i lartë i pushtetit shtetëror të Republikës Popullore të Shqipërisë", që "mban sovranitetin e kombit dhe të shtetit dhe ushtron të drejtat sovrane"*. Mbetën të paprekura kompetencat për ndryshimin e Kushtetutës, miratimin e ligjeve, vendimin mbi pajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën, interpretimin e tyre, miratimin e buxhetit, ratifikimin e traktateve ndërkombëtare, dhënien e amnistisë, vendimi mbi referendumet, zgjedhja e shkarkimi i Presidiumit, qeverisë, gjykatës së lartë, prokurorit, etj. Të gjitha këto kompetenca kushtetuese ishin formale dhe gjatë 1945-1990 asnjëherë parlamenti nuk mori një vendim kritik ndaj qeverisë dhe organeve të zgjedhura prej Byrosë Politike, nuk zhvilloi debat politik dhe as nuk inicioi ligje apo akte të tjera legjislative. Formalisht u ruajt tradita e mbledhjeve periodike dy herë në vit, e drejta për vërtetimin dhe anulimin e mandateve të deputetëve, etj. Zgjedhjet për Kuvend zhvilloheshin çdo katër vjet, me listë kandidatësh në emër të Frontit Demokratik, me përllogaritje një deputet për çdo 10 mijë banorë[38]. Kuvendi do të drejtohej nga një kryetar,

---

[34] Luan Omari. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.
[35] Akademia e Shkencave. Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (1985), f.587
[36] Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.
[37] Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.
[38] Luan Omari: "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.

një nënkryetar dhe një sekretar. Në dallim nga parlamentet e mëparshme kryesia nuk do të zgjidhej çdo sesion parlamentar, por njëherë në katër vjet.

Në praktikë Kuvendi i modelit të Republikës Popullore ishte organ formal, pa debate dhe aktivitet të ngjeshur, me parlamentarë të emëruar nga organet më të larta të partisë, me votime të hapura dhe gjithnjë unanime, pa deputetë të paguar dhe si i tillë, pa politikanë profesionistë. Për më tepër, nuk ekziston asnjë rast që parlamenti të ketë marrë në shqyrtim apo debatuar mbi qeverinë, punën e ndonjë kryeministri apo ministri të veçantë. Nuk ka patur raste mocioni dhe as votimi kundër, raste të interpelancave apo të pyetjeve drejtuar kryeministrit, etj. Deputetët fillimisht u zgjodhën nga figura besnike të luftës, më pas një përzierje midis figurave kryesore partiake dhe figurave të reja, kryesisht nga veprimtaritë prodhuese, nga bujqësia etj. Formalizmin e Kuvendit Popullor si institucion dhe të deputetit si përfaqësues i qytetarëve, e shpreh më së miri edhe Udhëzimi i Presidiumit të Kuvendit Popullor, datë 10.10.1967. Ky dokument zyrtar[39] urdhëroi deputetët të mos takohen me zgjedhësit e tyre më shumë se dy herë në vit dhe në total, më shumë se 20 ditë në vit. Konkretisht, Udhëzimi thekson se *"takimet e deputetëve me zgjedhësit e zonës së tyre nuk mund të jenë më shumë se 20 ditë në vit, kur shkojnë jashtë rrethit të banimit dhe më shumë se 10 ditë kur shkojnë brenda rrethit"* dhe se *"deputetët, zakonisht, marrin takim me zgjedhësit dy herë në vit, pas çdo sesioni, si dhe kur kjo u rekomandohet nga Kryesia e Kuvendit Popullor ose nga Presidiumi i tij".*

Institucion po aq formal ishte edhe ai i Kryetarit të Shtetit. Në monarki ky funksion u përmbush nga Mbreti, në republikën e parë nga Presidenti, në periudhën e regjencave nga një Këshill i Lartë, kurse në modelin republikan u ruajt forma e drejtimit kolektiv[40], "*Presidiumi i Kuvendit Popullor",* i përbërë prej një kryetari, tre nënkryetarëve, një sekretari dhe dhjetë anëtarëve. I njëjti model aplikohej edhe në Bashkimin Sovjetik, ndaj u mor si i tillë edhe për të gjitha shtetet komuniste, përfshirë

[39] *Arkivi Shtetëror, Qendra e Publikimeve Zyrtare, (ëëë. qpz.gov.al)*
[40] *Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë. 1946.*

Shqipërinë. Sipas nenit 58 të Kushtetutës, Presidiumi i Kuvendit Popullor, ndryshe nga Kuvendi Popullor, ishte *"organ i lartë i pushtetit shtetëror, me veprimtari të përhershme"*. Ai kishte disa kompetenca klasike për kryetarët e shtetit, me specifikën e emërimit dhe pushimit të ministrave në mes dy sesioneve parlamentare, krijimi i komisioneve brenda qeverisë, etj. Zyrtarisht Presidiumi i Kuvendit Popullor ishte përgjegjës për veprimtarinë e tij përpara Kuvendit Popullor. Ky mund ta revokonte Presidiumin, të zgjedhë një tjetër, të revokojë anëtarët dhe t'i zëvendësojë edhe përpara mbarimit të afatit për të cilin janë zgjedhur. Një dallim i vetëm mund të quhet ushtrimi i kompetencave të Kuvendit, sidomos në interpretimin e ligjeve, në rastet kur Kuvendi nuk është i mbledhur. E vetmja kompetencë në mungesë që nuk e ushtron ishte ndryshimi në Kushtetutë. Për shkak se Kuvendi mblidhej rrallë dhe vetëm për disa ditë, në realitet të gjitha kompetencat e tij iu deleguan dhe u ushtruan nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Ndërkohë Presidiumit iu dha edhe përgjegjësia për të drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë e këshillave popullore. Ai kishte kompetencë të shpërndajë këshilla popullore, të caktojë komitetet ekzekutive përkatëse të përkohshme dhe të vendosë për zgjedhjen e një këshilli popullor të ri. Ai gjithashtu mund të shfuqizonte aktet e paligjshme ose të parregullta të Këshillit të Ministrave, të këshillave popullore dhe të komiteteve ekzekutive, një kompetencë shumë më e gjerë, sesa ajo e parlamenteve në republikat parlamentare, por që nuk u aplikua asnjëherë. Në thelb kompetencat, përbërja dhe roli i tij praktik edhe më 1976 mbetën të pandryshuara nga modeli i vitit 1946[41].

Në modelet e mëparshme kushtetuese kryetari i shtetit kishte një mandat e imunitet shumë herë më të madh, sesa ai i Kushtetutës së vitit 1946 dhe 1976. Në fillimet e aktivitetit të tij presidiumi drejtohej nga Omer Nishani, ish-kryetar i KANÇ-ës, kurse pas vdekjes së tij më 1953 dhe deri më 1982 kryetar i Presidiumit ishte Haxhi Lleshi. Më 1982-in drejtimin e Presidiumit e mori Ramiz Alia, i cili gjatë viteve 1985-1991 e ushtroi funksionin bashkë me detyrën tjetër të Sekretarit të Parë të KQ të

[41] *Krasniqi, Afrim. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.*

PPSH-së. Në të gjitha rastet presidiumi dhe kryetarët e tyre ishin honorifikë, me detyra e përgjegjësi të kufizuara, noterë të bindur të vendimeve që merreshin nga strukturat e tjera partiake. Gjatë 46 viteve Presidiumi nuk ktheu asnjë ligj të Kuvendit, nuk mori asnjëherë ndonjë vendim ndryshe nga vendimi paraprak i Byrosë Politike, si dhe nuk pati njohje publike në krahasim me anëtarët e Byrosë. Presidiumi u bë i njohur në fundin e viteve '80 kryesisht për shkak se drejtohej nga Alia, njëherësh edhe drejtuesi kryesor i PPSH, dhe p.sh, studentët protestues në dhjetor 1990 preferuan t'i drejtohen atij në funksionin e Presidiumit, jo të PPSH. Rreth gjysma e Presidiumit përbëhej nga anëtarë të Byrosë dhe drejtues të lartë të PPSH, gjysma tjetër nga figura simbolike, pa ndonjë rol e identitet politik, kryesisht ushtarakë, shkrimtarë, doktorë, skulptorë, nëpunës/kooperativistë, drejtues të organizatave të masave, etj[42].

Institucioni i tretë i rëndësishëm, pushteti ekzekutiv, mbeti klasik në funksione e përgjegjësi. Sipas Kushtetutës qeveria përfaqësonte organin ekzekutiv dhe urdhërdhënës më të lartë të Republikës Popullore[43], pozitë që nuk i përgjigjej piramidës politike vendimmarrëse. Në realitet ajo ishte në renditje hierarkike politike pas Byrosë, Sekretariatit të KQ, Plenumit dhe Presidiumit. Qeveria formalisht emërohej dhe shkarkohej nga Kuvendi, duhej të jepte llogari përpara tij, dhe në rastin e pushimeve parlamentare organi kontrollues do të ishte Presidiumi i Kuvendit. Qeveria i ushtronte kompetencat e saj përmes vendimeve dhe urdhëresave, si dhe kontrollit të zbatimit të tyre. Përveç kompetencave të njohura të qeverisë në çdo sistem politik, modeli qeveritar i republikës popullore përcaktonte dhe përgjegjësinë e qeverisë për drejtimin dhe

---

[42] Për ilustrim në vitet '50 Presidiumi përbëhej nga Haxhi Lleshi (kryetar), Pilo Peristeri dhe
Myslim Peza, Aleksander Xhuvani (nënkryetarë), Sami Baholli (sekretar), si dhe anëtarë Rita Marko, Liri Belishova, Ramiz Alia, Vito Kapo, Qirjako Harito, Delo Balili, Myqerem Fuga, Et'hem Berhami, Gjovalin Luka / Sadik Bekteshi. Presidiumi i fundit i periudhës komuniste (1987-1990) përbëhen nga R.Alia (kryetar), Rita Marko, Xhafer Spahiu dhe Emine Guri (nënkryetarë), Sihat Tozaj (sekretar), si dhe anëtarë Eleni Selenica, Faik Çinaj, Kristaq Rama, Lumturi Rexha, Petrit Gaçe, Rahman Hanku, Simon Ballabani, Sotir Kocollari, Stefan Qirjako dhe Terezina Marubi.
[43] Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.

organizimin e përgjithshëm të ushtrisë, caktimin e organizimit të brendshëm të ministrive dhe të instituteve kushtetuese, etj. qeveria drejtohej nga kryetari i qeverisë, dhe përbëhej nga kryetari, nënkryetarët, ministrat dhe kryetari i Komisionit të Planit.

Një veçori e pozitës kushtetuese të qeverisë së Republikës Popullore 1946-1976 ishte caktimi me Kushtetutë i posteve përbërëse të qeverisë, dhe konkretisht i 17 ministrive[44]. Në asnjë Kushtetutë të mëparshme nuk ishin paraparë postet ministrore dhe përbërja e kabinetit qeveritar. Nga emërtimet e sotme të ministrive një veçori paraqet ekzistenca e ministrisë së Kontrollit si dhe e Grumbullimit. Kabineti qeveritar i krijuar nga KANÇ-i më 1944 vijoi të ishte në detyrë deri në miratimin e Kushtetutës së re. Në këtë kabinet Enver Hoxha ishte kryetar, zëvendës i tij dhe ministër i brendshëm Koci Xoxe. Ministër ishte edhe Omer Nishani, i cili njëherësh ishte edhe kryetar shteti, (kryetar i KANÇ/Presidiumit), organ, i cili me Kushtetutë dekretonte emërimin dhe shkarkimin e qeverisë, pra të vetvetes. Në vitet e para Hoxha ishte njëherësh kryeministër, ministër i mbrojtjes dhe i jashtëm, pra ushtrues i tre posteve më të larta në qeveri. Po ashtu, një pjesë e ministrave ndërronin pozicionin duke ruajtur poste në qeveri, ndërkohë që më 1948-ën figura si Xoxe u eliminuan nga jeta politike dhe më pas edhe nga qeveria. Gjatë viteve të para të vendosjes dhe funksionimit të qeverisë komuniste u bënë ndryshime të tjera, sidomos në vitin 1954, kur për herë të parë Hoxha dha dorëheqje nga posti i kryetarit të qeverisë dhe mbajti për vetë postin e Sekretarit të Parë të KQ-së të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ndarja e posteve partiake e qeveritare u aplikua edhe për disa drejtues të tjerë të rëndësishëm të partisë – shtet. Ky zhvillim nuk erdhi nga nevoja për distancimin e ndikimit të partisë në qeveri dhe pushtetet e tjera, por për qëllimin e kundërt, për forcimin e kontrollit politik e partiak mbi çdo pushtet dhe sektor tjetër shtetëror e publik.

Kushtetuta e vitit 1976 nuk solli ndryshime të rëndësishme në pozitën e qeverisë. Qeveria zgjidhej në sesionin e parë të parlamentit, dhe në dallim nga viti 1946, përbërja nominale e ministrive nuk përcaktohej në

[44] *Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.*

kushtetutë, por rregullohej me ligj të veçantë. Kushtetuta e re përcaktoi rregullimin e emërimit "ministër" kryesisht nga radhët e deputetëve të Kuvendit Populor. Një dallim teknik ishte përcaktimi me kushtetutë i kryesisë së Këshillit të Ministrave, e cila përbëhej nga Kryetari dhe zëvendëskryetarët. Gjatë 1945-1990 Shqipëria pati vetëm 3 kryeministra (Hoxha, Shehu, Çarçani), nga të cilët Shehu ishte mbajtësi rekord i postit në të gjithë Europën komuniste (27 vjet) derisa më 1981 nën presionet e rivaliteteve brenda Byrosë Politike kreu vetëvrasje.

Institucione të tjera, përfshirë ato ekonomike, administrative, akademike, sociale, etj, ishin më shumë organe zbatimi të vendimeve / ligjeve, sesa institucione me të drejtë propozimi dhe me ndikim në procesin politik e qeverisës. Për shembull, Kushtetuta e vitit 1976 i njohu një vend specifikim rolit të Ushtrisë Popullore[45]. Misioni i saj kushtetues do të ishte *"mbrojtja e atdheut dhe e fitoreve të socializmit* nën udhëheqjen nga Partia e Punës e Shqipërisë". E hartua vetëm dy vjet pas masave represive që Hoxha mori në sektorin ushtarak, të cilat çuan në pushkatimin e ministrit të mbrojtjes, shefit të shtabit dhe disa funksionarëve të tjerë të lartë ushtarak. Kushtetuta e re kërkoi të japë garanci të plota të kontrollit personal nga udhëheqësi komunist i ushtrisë. Për këtë Kushtetuta shprehej saktësisht se *"sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes"*[46]. Për drejtimin e tyre krijohej Këshilli i Mbrojtjes. Anëtarët e tjerë të Këshillit emëroheshin nga Kuvendi me propozim të Kryetarit të Këshillit. Kjo është hera e parë që në një kushtetutë shqiptare përfshihet shprehimisht një funksion partiak, siç ishte ai i Sekretarit të Parë të KQ të PPSH-së. Një model i tillë nuk gjendet as në kushtetutat e tjera të vendeve ish-komuniste.

E njëjta praktikë kushtetuese dhe ligjore kontrolli politik u aplikua edhe në sistemin e drejtësisë dhe institucionet e akuzës. Dhënia e drejtësisë, sipas kushtetutës, ishte përgjegjësi e gjykatave popullore, të cilat

---

[45] *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.*

[46] *Krasniqi, Afrim. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.*

"mbrojnë rendin juridik socialist, luftojnë për parandalimin e krimeve, edukojnë masat punonjëse me frymën e respektimit e të zbatimit të ligjshmërisë socialiste, duke u mbështetur në pjesëmarrjen aktive të tyre". Niveli më i lartë ishte Gjykata e Lartë, e cila zgjidhej nga Kuvendi Popullor në sesionin e tij të parë. Me ligjin e vitit 1968 "Mbi organizimin gjyqësor të RPSH-së" theksohej parimi[47] se *"drejtësia jepet nga gjykata popullore të cilat kanë për qëllim të mbrojnë nga çdo cenim rendin shoqëror dhe shtetëror socialist, sistemin socialist të ekonomisë dhe fitoret e tjera të revolucionit popullor, të drejtat dhe interesat e shtresave dhe organizatave socialiste..".* Sipas nenit 4, *"gjykatat popullore në veprimtarinë e tyre udhëhiqen nga politika e Partisë".*

Sistemi i gjykatave përbëhej nga pesë nivele: gjykata e lartë, gjykata e rretheve, gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve. Në trupin gjykues të tre niveleve të fundit të gjykatave, bënin pjesë edhe aktivistë shoqërorë, të zgjedhur *"për çdo vit nga mbledhja e popullit në fshat, në qytet dhe në lagjet e qyteteve".* Në nivel më të lartë ishin gjykatat e rretheve, drejtuesit e të cilave caktoheshin prej këshillit popullor. Pranë tyre vepronte gjyqi ushtarak. Organi më i lartë i sistemit gjyqësor ishte Gjykata e Lartë. Kryetari dhe anëtarët e saj jepnin llogari *"para Kuvendit Popullor dhe Presidiumit të tij",* kurse gjyqtarët e thjeshtë e ndihmësgjyqtarët jepnin llogari *"para zgjedhësve".* Sipas këtij ligji *"gjyqtari dhe ndihmës gjyqtari mund të shkarkohen nga detyra vetëm, kur e vendosin zgjedhësit ose organi që i ka zgjedhur, kur dënohen penalisht ose, kur e kërkojnë vetë për shkaqe të arsyeshme"*, kufizim që praktikisht u heq gjyqtarëve çdo imunitet ndaj kritikave dhe dëshirave që vinin nga PPSH-ja dhe strukturat e saj mbështetëse.

Rreth 10 vjet pas miratimit të kushtetutës, u bë edhe ligji i ri për organizimin gjyqësor në RPSSH. Në këtë ligj të vitit 1987, gjykatat shndërroheshin edhe ligjërisht në struktura penale të Partisë së Punës së Shqipërisë, pra partisë - shtet. Sipas nenit 1 të këtij ligji,[48] *"gjykatat popullore kanë për detyrë të mbrojnë shtetin e diktaturës së proletariatit, Partinë e Punës së Shqipërisë, të drejtat dhe interesat e shtetasve, rendin juridik socialist, të ndihmojnë*

---

[47] *Gazeta Zyrtare, Ligji "Mbi organizimin gjyqësor të RPSH", Tiranë, 1968.*
[48] *Gazeta Zyrtare, Ligji "Mbi disa ndryshime në ligjin mbi organizimin gjyqësor të RPSH", Tiranë, 1987.*

ndërtimin socialist të vendit sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta dhe të luftojnë për mbrojtjen e pronës socialiste e për forcimin e disiplinës proletare në punë". Neni dy thelloi edhe më tej ideologjizimin e ligjit, duke përcaktuar se *"gjykatat, në veprimtarinë e tyre, udhëhiqen nga politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe bazohen në ideologjinë e klasës punëtore, marksizëm-leninizmin"*. Neni 3 sanksionoi parimin kryesor drejtues të partisë-shtet, luftën e klasave. Sipas këtij neni, *"gjykatat, në veprimtarinë e tyre, i përmbahen parimit të luftës së klasave"*.

Një dallim thelbësor nga modelet e tjera kushtetuese ishte heqja e organit të avokatisë dhe shkrirja e Ministrisë së Drejtësisë. Ky vendim u mor me argumentin se të drejtat e qytetarëve garantohen nga partia – shtet dhe nuk është e nevojshme që të ekzistojnë avokatët, të cilët konsideroheshin mbetje e sistemit të vjetër kapitalist e monarkist. Po ashtu, u vendos shkrirja e Ministrisë së Drejtësisë dhe të gjitha kompetencat në çështjet e ligjshmërisë i kaluan direkt drejtorive përkatëse në Komitetin Qendror të PPSH-së. Anullimi i këtij vendimi unikal në të gjitha vendet komuniste, u bë shumë vonë, në verën e vitit 1990, vetëm disa muaj përpara rënies së sistemit komunist[49].

Një organ tjetër kushtetues ishte prokuroria e përgjithshme, e cila gëzonte gjithashtu të drejtën *"e protestës kundër çdo akti të paligjshëm dhe të kërkojë nga organet përkatëse shfuqizimin ose ndryshimin e tij. Kërkesa e prokurorit duhet të shqyrtohet brenda afatit të caktuar me ligj, ndryshe pezullohet zbatimi i aktit"*. Prokurori ishte përgjegjës përpara Kuvendit, ai raportonte në kuvend rastet, kur ligjet dhe dekretet ishin antikushtetuese dhe në qeveri, kur vendimet e saj ishin antiligjore.

Në ndarjen dhe organizimin administrativ të vendit nuk pati ndonjë risi të re. U ruajt modeli i drejtimit lokal me këshilla popullore, të cilat *"realizojnë qeverisjen në njësitë administrative-tokësore përkatëse" dhe "drejtojnë gjithë jetën shoqërore në fushën politike, ekonomike, social-kulturore, të mbrojtjes së vendit dhe të ruajtjes së rendit juridik socialist, duke pajtuar interesat lokale me interesat e përgjithshme shtetërore"*. Këshillat zgjidheshin çdo tri vjet, sipas listës zyrtare dhe të vetme të paraqitur nga Fronti Demokratik. Në rolin e

[49] *Krasniqi, Afrim. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.*

qeverisë lokale vepronte komiteti ekzekutiv, si organ *"ekzekutiv dhe urdhërdhënës i këshillit popullor*", i emëruar dhe nën varësi direkte politike nga Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror.

Elita drejtuese? Baza ishin punëtorët dhe fshatërësia

Në thelbin e Kushtetutës së RP (1946)[50] Shqipëria shpallej Republikë Popullore: *"shtet i punëtorëve dhe fshatarëve punonjës"*. Baza e pushtetit do të ishin *"këshillat popullore që lindën gjatë luftës nacional-çlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit dhe u forcuan me fitoren historike të kësaj lufte dhe gjatë ndërtimit të bazave të socializmit"* dhe se *"i gjithë pushteti në Republikën Popullore të Shqipërisë u përket punonjësve të qytetit dhe të fshatit, të përfaqësuar nga këshillat popullore"*. Identifikimi i shtetit dhe regjimit me fshatarët dhe punonjësit kishte arsyet e veta identitare dhe ideologjike. Në prag të Kongresit të Parë të PPSH dy drejtuesit kryesorë, Enver Hoxha dhe Koci Xoxe, në një letër drejtuar Sekretarit të KQ të PKBS A.Zhdavov propozonin ndryshimin e emrit të PKSH në PPSH me argumentin kryesor se në përbërjen e Partisë 80-90% ishin fshatarë dhe klasë punëtore[51]. Megjithëse relacioni pranon se masat fshatare i druhen kolektivizimit dhe komunizmit, ata vlerësojnë se është më e lehtë kontrolli i tyre dhe se në hartimin e dokumenteve bazë ishin marrë si modele referimi nga Partia Komuniste Pansovjektike (bolshevike), Partia Punëtore Bullgare dhe Partia Komuniste Rumune.

I njëjti raport ofron detaje domethënëse të përbërjes së PPSH, parti e cila qeveriste vendin prej vitit 1944. Në informacion theksohet: *"Në parti ka vetëm 40-50% analfabetë. Janë të paarsimuar 1607 anëtarë partie ose 10.9% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Kanë përfunduar shkollën fillore 10,759 anëtarë partie ose 73%, kanë përfunduar jo plotësisht gjimnazin 1354 anëtarë partie ose 9,2%, kanë përfunduar kursin e plotë të gjimnazit 801 anëtarë partie ose 5,4%, studentë universiteti 175 anëtarë partie ose 0,03% e numrit të përgjithshëm të*

[50] Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.
[51] Kaba Hamit, Ethem Ceku. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962, IH/ASA, Tiranë 2017, f. 51.

anëtarëve të partisë sonë"[52]. Kjo përbërje dominuese me përfaqësues nga fshatarët e klasa punëtore reflektohej në të gjithë strukturën partiake. Në raportin e Kongresit II të PPSH Hoxha raportoi se rreth mbi 90% e anëtarëve të PPSH ishin pa shkollë ose deri me 7 klasë shkollë (shih tabelën më poshtë).

PËRBËRJA E PPSH	ANËTARË	KANDIDATË	TOTAL	TOTAL (NË %)
Analfabetë	289	723	1012	2,2
Me shkollë të pambaruar	7543	5847	13390	30,1
Me fillore	15356	6464	21820	49,1
Me 7 vjecare	3992	921	4913	11
Me profesionale të ulët	312	52	364	0,8
Me të mesme	2045	399	2444	5,5
Me të mesme profesionale	299	57	356	0,8
Me universitet	96	23	119	0,2
Totali	29932	14486	44418	99,7

Burimi: E.Hoxha, Vepra 9, Raport në Kongresin II të PPSH, 1952, f.240.

E njëjta përbërje, me tendencë kontrollin e pushtetit përmes fshatarësisë dhe klasës punëtore, u reflektua edhe në përbërjen e organit më të lartë përfaqësues, Kuvendit Popullor. Tabela më poshtë ilustron përbërjen e Kuvendit midis viteve 1970-1990, pra rreth 15 vjet pasi ishte krijuar Universiteti i Tiranës dhe Shqipëria kishte tashmë kapacitete shoqërore të kualifikuara, elitë kulturore dhe intelektuale, kishte mijëra të

[52] *Kaba Hamit, Ethem Ceku. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962, IH/ASA, Tiranë 2017, f.55.*

diplomuar brenda e jashtë vendit (ish-republikat sovjetike, vendet arabe, në Kinë, etj). Sic del nga tabela, më 1970 më shumë e një e treta e Kuvendit ishte e përbërë nga punëtorë dhe kooperativistë, por pas 1978 përqindja rritet ndjeshëm, deri në 67%, pra dy të tretat e Kuvendit Popullor. Ironia është se p.sh; më 1974 autoritetet deklaronin se numri i individëve që po ndiqnin ose kishin mbaruar shkollat e larta ishte rritur 172% në raport me periudhën përpara LIIB, me 6497 të diplomuar brenda vendit në vitet 1971-1974, 11247 të diplomuar midis 1961-1970, si dhe me 1371 të diplomuar jashtë vendit midis 1951-1960 dhe 45 të diplomuar gjatë 1971-1974. Vetëm stafi universitar në shkollat, institutet dhe akademitë e larta, më 1974 përbëhej nga 1291 persona (pedagogë, asistentë, etj)[53]

PËRFAQËSIMI I PUNËTORËVE E KOOPERATIVISTËVE NË KUVENDIN POPULLOR 1970-1990

Kategoritë	1970	1974	1978	1982	1987
Punëtorë	48	37	94	95	79
Kooperativistë	40	43	47	73	75
Së bashku	88	80	141	168	154
Në total (%)	35%	32%	56%	67%	62%

Të dhënat e përbërjes së Kuvendit Popullor në vitet 1982-1991, pra të dekadës së fundit të periudhës komuniste tregojnë gjithashtu se ekspertët e fushës juridike dhe ekonomike kishin përfaqësim simbolik përballë përfaqësimit të gjerë të kategorive të tjera, kryesisht kooperativistë

[53] *Drejtoria e Përgjithshme e Statistikave. 30 vjet Shqipëri Socialiste, Kuvendi Popullor, 1974, f.209-210.*

dhe punëtorë. Ironia është se legjislatura e fundit (1987-1991) ka 1% më shumë kooperativistë në Kuvend se në legjislaturën paraardhëse, megjithëse në këtë periudhë dështimi i modelit të kolektivizimit po pranohej gjithnjë e më shumë. Gjithashtu në legjislaturën e fundit u shtua përfaqësimi i ushtarakëve në parlament, ndërsa ra përfaqësimi i juristëve dhe mësuesve/pedagogëve. Mjaftojnë këto të dhëna për të kuptuar se edhe pas vdekjes së diktatorit Hoxha dhe hyrjes së vendit në atë që Ramiz Alia e quante "periudha e demokratizimit", një aludim për ndjekjen e modelit të reformave të nisura nga Gorbaçov, - vijnë në kontrast të thellë me preferencën dhe elitën vendimmarrëse të regjimit.



Të dhëna të tilla të plotësuara edhe me përbërjen e Byrosë Politike në vite, kryesisht në periudhën e parë (1944-1948) dhe në vitet '70, gjatë të cilave u promovuan figura politike pa arsim të lartë ose jashtë elitës politike të kohës, - nxjerrin në pah edhe nivelin problematik përfaqësues të elitës vendimmarrëse gjatë periudhës komuniste. Figurat politike të dekadës së parë të periudhës komuniste, të cilët kishin studiuar filozofi, shkenca apo në fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë u eliminuan periodikisht, ndërkohë që emrat më të suksesshëm mbeten kryesisht

individët pa arsim të lartë të përfunduar ose me arsim të lartë politik (përfshirë katër figurat kryesore të regjimit, Enver Hoxha, Ramiz Alia, Haxhi Lleshi dhe Hysni Kapo). Promovimi i kriterit të besnikërisë mbi kriterin e aftësisë profesionale ndihmoi në trajtimin e elitës ekonomike, kulturore dhe sociale në vend, si shtresë e nënçmuar, e kategorisë së dytë, e mbajtur nën vëzhgim e kontroll dhe me potenciale për fushata represive ndaj tyre. Pas fundit të viteve '60 dhe fillimeve të viteve '70 shoqëria shqiptare u identifikua me fushatën e krijimit të njeriut të ri, një nocion për modelin e elitës, - besnike, ideologjike, zëdhënëse, përçuese e mendimit politik, e nënshkruar dhe pa identitet të veçantë. Kjo është edhe një prej dallimeve thelbësore midis vetë shoqërive komuniste si ajo në Shqipëri dhe ato në Hungari, Çekosllovaki apo Poloni.

Zgjedhjet formale dhe fushatat e spastrimeve në PPSH

Koncepti i zgjedhjeve në periudhën 1946-1990 ishte formal në procedurë dhe rëndësinë e tyre. Kushtetutat e vitit 1946 dhe 1976 e përfshinin konceptin e zgjedhjeve, por ndërkohë me nene të tjera brenda saj, ose me ligje të tjera paralele. Parimet e votës së fshehtë dhe zgjedhjeve zëvendësoheshin me votimin formal dhe të hapur pro listës së regjimit. Sipas Kushtetutës së RPSSH[54] lejohej mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta, të drejtpërdrejta dhe të fshehta, duke përsëritur formulën e vitit 1946: *"Zgjedhësit kanë të drejtë të heqin në çdo kohë përfaqësuesin e tyre, kur ky ka humbur besimin politik, kur nuk plotëson detyrat e ngarkuara ose kur vepron në kundërshtim me ligjet"*. Në mënyrë më të detajuar, në nenin 19 të ligjit për zgjedhjet e Kuvendit Popullor, të këshillave popullore dhe të gjykatave popullore përcaktohej se *"kanë të drejtë të paraqesin kandidatë ose lista kandidatësh në zgjedhje: Organizatat e Partisë së Punës së Shqipërisë, të Frontit Demokratik, të Bashkimeve Profesionale, të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, të Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe organizatat e tjera të masave"*[55].

---

[54] *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.*
[55] *Fletore Zyrtare, 1967, Dekret 4243, dt.13.3.1967.*

Në praktikë Kushtetuta e RPSSH përcaktoi numrin 25o deputetë për Kuvendin Popullor, të cilët duhej të ishin të zgjedhur me një listë të vetme dhe pa konkurrentë, sipas listës së hartuar dhe e paraqitur në emër të Frontit Demokratik. Mandati i Kuvendit mbeti i pandryshuar, 4 vjeçar. Zgjedhjet zhvilloheshin në disa nivele: zgjedhje për deputetë, zgjedhje për në këshillat popullore dhe zgjedhje për gjyqtarë të rretheve. Zgjedhjet më të rëndësishme duhej të ishin ato për parlamentin.

Në kuptimin komunist proceset zgjedhore konsideroheshin ditë feste kombëtare, në të cilën çdo qytetar me të drejtë vote, ishte i detyruar (jo nga ligji) të merrte pjesë në zgjedhje. Kur kishte raste individuale të mospjesëmarrjes në votim, organet e hetimit dhe Sigurimi i Shtetit evidentonin personat, të cilët në rastin më të mirë përfundonin në burgjet politike ose në kampet e internimit, duke e konsideruar refuzimin e votimit si akt kundër shtetit komunist. Në mesin e viteve '70 u eliminua edhe formalisht dhoma e fshehtë e votimit, me argumentin se se ajo është e tepërt dhe penguese për qytetarët që donin t'i shprehnin dashurinë dhe besnikërinë partisë.

Duke mos lejuar subjekte të tjera politike, duke mos patur vëzhgues të brendshëm dhe të huaj, media të lira apo mundësi ankimi ndaj shkeljeve të mundshme administrative në zgjedhje, zgjedhjet për Kuvendin ose këshillat popullore e humbën tërësisht kuptimin e tyre dhe u shndërruan në veprim formal. Për të krijuar një ide më të qartë rreth konceptit komunist për zgjedhjet dhe rezultatet e tyre na ndihmon tabela bashkëngjitur, e cila paraqet rezultatet zyrtare të zgjedhjeve për Kuvendin Popullor midis viteve 1945-1990. Vetëm në zgjedhjet e vitit 1945 pati refuzim dhe votë kundër, në zgjedhjet vijuese asnjë votë nuk është "kundër", por e "pavlefshme".

TË DHËNAT ZYRTARE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN POPULLOR 1946-1990

Data e zgjedhjeve për Kuvendin Populloor	*Pjesëmarrja (në %)*	*Votuan për kandidatët e Frontit Demokratik*
2 dhjetor 1945	89,81%	93,16%
28 maj 1950	99,43%	98,28%
30 maj 1954	99,92%	99,86%
1 qershor 1958	99,98%	99,96%
3 qershor 1962	99,99%	99,99%
10 korrik 1966	99,99%	99,99%
20 shtator 1970	100%	100%
6 tetor 1974	100%	100%
12 nëntor 1978	99,99%	100%
14 nëntor 1982	100%	99,99%
1 shkurt 1987	100%	100%

Institucioni formal i zgjedhjeve shoqërohej me institucione formale si produkt i tyre. Le të shohim një tregues domethënës për ilustrim. Sipas Kushtetutës së re (neni 53) deputetët gëzonin imunitet tradicional, por që faktikisht në asnjë rast ky përcaktim kushtetues asnjëherë nuk u respektua. Në çdo rast shkarkimi dhe arrestimi i deputetëve u bë me vendim paraprak të Byrosë Politike dhe jo me vendim të vetë Kuvendit, siç e parashikonte Kushtetuta. Në dallim nga dokumentet kushtetuese të periudhës së republikës dhe monarkisë, Kushtetuta e vitit 1946 dhe ajo e vitit 1976 përfshiu parimin e revokimit të mandatit të deputetit. Futja e këtij koncepti ka të bëjë me synimin për të ushtruar presion politik mbi secilin prej deputetëve, mandati i të cilëve në rrethanat e partisë – shtet, ishte lehtësisht i cenueshëm.

Tabela e mëposhtme publikohet për herë të parë dhe tregon rastet e deputetëve të arrestuar dhe të dënuar gjatë periudhës komuniste 1945-1990. Në total janë 54 deputetë, por kurba tregon një zhvillim interesant.

Dy janë periudhat e dënimeve më të shumta, fillimisht legjislatura e parë e vitit 1945-1950, gjatë të cilës pati dënime kolektive të deputetëve kritikë dhe atyre që nuk përfaqësonin 100% frymën ideologjike të kohës. Pothuajse i njëjtë është edhe numri i deputetëve të dënuar në legjislaturën 1974-1978, kohë kur asnjë deputet nuk ishte kritik dhe as me mendim ndryshe nga vija zyrtare ideologjike e PPSH. Ata janë viktima të fushatës së spastrimeve politike në sektorët e kulturës, mbrojtjes, industrisë etj. Heqja e mandatit dhe dënimi ishte akt formal, pas miratimit paraprak nga Hoxha dhe Byroja Politike. Për të ilustruar një rast konkret, domethënës është shkarkimi i Kryetarit të Kuvendit Popullor dhe heqja e mandatit të deputetit Fadil Paçrami[56], i cili më pas u dënua me 25 vjet burg dhe kreu 17 vjet, duke u liruar vetëm më 1991, tre muaj pas ndryshimit të sistemit politik. Shumica e deputetëve të tjerë u ekzekutuan, - dënimi më i ashpër për një individ, megjithëse të gjithë akuzoheshin për akte që nuk i kishin kryer dhe natyrisht, edhe pa prova dhe pa procese gjyqësore të rregullta.

---

[56] Sipas informacionit zyrtar më 11 korrik 1973 punonjësit e NB "Ylli i Kuq" Kamëz thirrën për të dhënë llogari kryetarin e Kuvendit Popullor. Informacioni tregon[56]: "Mbledhja u zhvillua në sallën e kinemasë, ku merrnin pjesë mbi 700 vetë, ndërsa të tjerët dëgjonin me altoporlante rreth Pallatit të Kulturës. Një orë para se të fillonte mbledhja në sallë nuk kishte vend të qëndroje në këmbë. Ajo filloi në orën 18.00 dhe mbaroi në 21.15". në fund të relacionit theksohet: "Mbledhja u zhvillua me një frymë të lartë luftarake e revolucionare. Me një entusiazëm të papërshkruar për partinë dhe udhëheqësin tonë të dashur shokun Enver. Brohoritjet për partinë dhe për shokun Enver ishin pa mbarim. Fadil Paçrami, me sa u duk, nuk parashikonte që t'i bëhesh një demaskim i tillë i tmerrshëm dhe i argumentuar nga ana e punëtorëve, ai mendoi se do ta kalonte lehtë dhënien e llogarisë përpara popullit. Mbledhja do të vazhdonte deri në orët e vona, asnjeri nuk donte të largohej pa e demaskuar, megjithëse në sallë bënte mjaft vapë. Mbas shumë diskutimesh nga të gjithë pjesëmarrësit u kërkua me insistim që Fadil Paçrami t'i jepet organeve të drejtësisë për ndjekje penale, si tradhëtar i partisë dhe i popullit, si revizionist i kulluar, që ka dashur të përmbysë pushtetin tonë popullor. Ata shprehën urrejtjen e madhe për armikun e klasës, për frikacakun e rënë në prehërin e imperialistëve e revizionistëve" (Meta, Krasniqi, Bello: "Indoktrinimi komunist përmes kulturës. Letërsisë dhe artit", Dokumente Historike, Vëllimi II, 1968-1973, IH/ASA, 2019.

Në dallim nga çdo praktikë tjetër e mëparshme republikane dhe monarkiste, në sistemin njëpartiak, ky institucion edhe pse nuk parashihej në Kushtetutë apo ndonjë ligj organik, praktikisht ishte institucioni kryesor vendimmarrës politik, legjislativ, ekzekutiv dhe në fushën e drejtësisë, ekonomisë, kulturës, etj. Ekzistenca e Byrosë Politike përmendet vetëm në një rast dhe në një rresht në statutin e PPSH-së të vitit 1948[57], me objekt pune aktivitetin politik dhe udhëheqjen e përgjithshme të punës organizative të Komitetit Qendror[58]. Zyrtarisht, pra, ajo ishte një nga hallkat e larta drejtuese të Partisë së Punës së Shqipërisë, e ngjashme në formë me kryesitë e partive të sotme politike në Shqipëri.



Fakti që edhe në vitin 1990 nuk ishin Kuvendi Popullor dhe Këshilli i Ministrave, por Byroja Politike dhe më pas Komiteti Qendror i

[57] Statuti i Partisë së Punës së Shqipërisë, në "Kongresi I i PPSH", Tiranë, 1950.
[58] Për statistikë, Byroja Politike që doli nga Kongresi i Parë i PPSH-së (1948) kishte 9 anëtarë[58]. Ata ishin: Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i PPSH, Tuk Jakova, Sekretar për Kuadrot, Mehmet Shehu, Sekretar i KQ-së, Bedri Spahiu, Sekretar i KQ-së dhe anëtarët Hysni Kapo, Godo Nushi, Liri Belishova, Spiro Koleka, Beqir Balluku. Në vitet e mëvonshme Jakova, Shehu, Spahiu, Belishova e Balluku do të ekzekutoheshin, burgoseshin apo shpalleshin armiq të atdheut.

PPSH-së, që nën presionin e demonstratave studentore, dhanë miratimin formal për lejimin e pluralizmit politik, tregon më së miri se parlamenti dhe qeveria ishin dy institucione inekzistente, pa pushtet politik dhe në shërbim të verbër ndaj Byrosë Politike të PPSH-së[59].

PPSH: organizimi dhe kurba e anëtarësisë 1946-1991

Organizimi politik dhe administrativ i PPSH ishte vertikal, në çdo sektor, fushë dhe institucion në Shqipërinë e viteve 1945-1990. Që në vitin 1948 në Kongresin e parë të saj, PPSH ishte vetëshpallur, "*fuqia udhëheqëse dhe drejtuese e gjithë organizatave punonjëse, si shoqërore, ashtu edhe shtetërore"*. Duke mos pranuar asnjë parti tjetër politike rivale ose në kooekzistencë, PPSH promovon modelin e partisë – shtet, përmes bashkimit të të gjithë forcave demokratike dhe progresiste të vendit tonë në Frontin Demokratik, të krijuar prej saj. PPSH deklaronte Bashkimin Sovjetik si model udhëheqës dhe angazhohej për një botë të dominuar nga konceptet marksiste e leniniste të qeverisjes. Në organizimin e saj ajo i përmbahej parimit të centralizmit demokratik dhe vetshpallej si "*një organizatë lufte unike, organizatë e lidhur me një disiplinë të ndërgjegjshme dhe të detyrueshme njësoj për të gjithë anëtarët e Partisë. Uniteti i PPSH është një konditë e domosdoshme për aftësinë e saj luftarake"*[60].

Duke qenë parti – shtet, pra një parti ku çdo anëtar mund të jetë njëherësh kandidat potencial për drejtimin e segmenteve të ndryshme të shtetit, ajo kërkonte nga anëtarësia e saj besnikëri e bindje pa kushte. Kjo është arsyeja që kriteret e pranimit në parti mbeten unike për të gjitha partitë politike shqiptare të çdo periudhe tjetër qeverisjeje. Në konceptin e PPSH-së, anëtari ideal ishte fshatari e punëtori që është *"luftëtar i vendosur për mbrojtjen dhe forcimin e pushtetit popullor", që është "luftëtar i vendosur kundër borgjezisë, kundër mbeturinave të fashizmit, feudalizmit dhe kundër reaksionit", që është i gatshëm të shndërrohet në agjitator i aftë i parimeve marksiste – leniniste, që ruan partinë nga "nga goditjet e armikut dhe unitetin e saj nga çdo armik i brendshëm*

[59] *Afrim Krasniqi. Partitë politike në Shqipëri 1912 - 2006", Tiranë, 2007.*
[60] *Po aty.*

dhe i jashtëm, duke zhvilluar vigjilencën revolucionare", etj. Për tu pranuar anëtar partie përveç kritereve politike dhe personale, duhej që një individ të kishte kaluar me sukses stazhin 1 vjeçar si kandidat. Për kandidatët që vinin nga radhët e punëtorëve kërkohej "*rekomandimi i dy anëtarëve të partisë që kanë jo më pak se një vit jetë partie dhe që e kanë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën 6 muajt e fundit*". Për kandidatët që ishin fshatarë të varfër kërkohej garancia e dy anëtarëve, me lehtësimin që vetëm njëri prej tyre të "*ketë njohur personalisht kandidatin të paktën 6 muajt e fundit*". Kriteret bëheshin edhe më të ashpra kur bëhej fjalë për pranimin në parti të kandidatëve që vinin nga shtresat intelektuale. Për këta të fundit kërkoheshin tre rekomandime të anëtarëve të partisë, por me kushtin që ata të kishin minimalisht *"tre vjet jetë partie dhe ta kenë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën vitin e fundit"*. Dhënia e rekomandimeve nuk ishte e mjaftueshme për marrjen e triskës (teserës) së anëtarësisë në parti. Fillimisht diskutohej e merrej vendim në organizatën bazë të partisë, më pas në Komitetin e Partisë në rajon apo qytet, dhe vetëm pas miratimit të tyre jepej dokumenti i anëtarësisë. Statuti tregohej përjashtues dhe i ashpër ndaj kërkesave për anëtarësim që mund të vinin nga ish anëtarët e partive të tjera politike të luftës, sidomos të Partisë Fashiste, të Ballit, të Legalitetit dhe të grupeve të ndryshme bajraktare. Anëtarësimi i tyre bëhej vetëm në raste "speciale", me rekomandim të tre anëtarëve të partisë, me kusht që rekomanduesit të kishin minimalisht 5 vite jetë partie dhe madje, njëri prej tyre duhej të kishte qenë anëtar partie përpara vitit 1943. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto kritere ekstreme, në fund kërkohej që miratimi paraprak për anëtarësinë të bëhej nga organi më i lartë i partisë, Komiteti Qendror. Në të gjitha rastet për gabimet e mundshme me anëtarësimet, përveç dënimit të personit konkret, përgjegjës bëheshin edhe personat rekomandues.

Stazhi njëvjeçar i kandidatëve për anëtar partie bëhej me qëllim që ai "të marrë njohuritë e programit, të Statutit, të taktikës së partisë dhe që organizata të jetë në gjendje të vërtetojë cilësitë personale të kandidatit". Edhe në rastin e kandidatit kërkoheshin rekomandime, si në rastin e pranimit në parti. Megjithëse kishte një pozitë zyrtare të lartë dhe gëzonte

imunitet politik, një komunist nuk kishte të drejtë të ndërronte vendbanim, nëse nuk merrej më parë leja e organizatës bazë të partisë ku ai vepronte. Nga ana tjetër, ata anëtarë partie që lëviznin me leje nga një qendër banimi në një tjetër ishin të detyruar që menjëherë të regjistroheshin në organizatën e re bazë të partisë dhe të kryenin aty jetën partiake. Kushtet bëheshin edhe më të ashpra kur bëhej fjalë për mundësinë e lëvizjes së anëtarëve të partisë jashtë shtetit. Kështu, sipas nenit 10 të Statutit të PPSH-së, *"çdo anëtar partie kur shkon në ndonjë vend të huaj duhet të ketë lejen e Komitetit Qendror"*. Pra, organi më i lartë i partisë – shtet duhet të shqyrtojë dhe japë miratim nëse një nga mijëra anëtarët e kësaj partie mund të udhëtonte jashtë shtetit, qoftë edhe privatisht apo për arsye mjekësore.

Për PPSH parim organizativ i saj dhe i shtetit ishte centralizmi demokratik. Në bazë të këtij parimi zgjedhja e çdo organi drejtues bëhej *"nga poshtë – lart në mbledhje të përgjithshme, konferenca dhe kongrese", "organet drejtuese janë të detyruara të japin llogari periodikisht përpara anëtarëve të organizatave që i kanë zgjedhur"*, me disiplinë të hekurt pakica t'i nënshtrohet shumicës dhe vendimet e organeve të larta ishin detyruese për të gjithë partinë dhe organet e shtetit. Skema e organizimit të PPSH-së ishte e njëjtë në të gjitha modelet e partive komuniste të Evropës Lindore.

Në çdo lagje, fshat, njësi prodhimi, institucion, ndërmarrje apo bashkësi tjetër qytetare apo sociale, krijohej organizata bazë e partisë. Midis Kongreseve, Komiteti Qendror zhvillonte mbledhje një herë në 3 muaj, të cilat quheshin Plenume të KQ. Në Plenume merrnin pjesë anëtarët dhe kandidatët e KQ. Për punën politike dhe për udhëheqjen e përgjithshme të punës organizative Komiteti Qendror zgjidhte një Byro Politike, të përbërë nga 9-12 anëtarë dhe një sekretariat të KQ të përbërë nga 3-5 anëtarë. Statuti i PPSH nuk parashikonte në asnjë nen funksionet, zgjedhjen apo përgjegjësitë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, i cili praktikisht ishte njëherësh udhëheqësi i vetëm i partisë dhe shtetit. Në nivel qyteti, rrethi e rajoni vepronin Komitetet e Partisë, Konferenca e Partisë dhe organizatat bazë. Në nivel më të ulët vepronin organizatat bazë të partisë, të shtrira "në fabrikë, në transport, në ndërtime, në fshatra,

në institucionet e ndryshme". Organizatat bazë vepronin në çdo vend ku kishte jo më pak se tre anëtarë partie. Në vendet me më pak se tre anëtarë, "formohen grupe kandidatësh partie, që udhëhiqen nga një anëtar partie i caktuar nga Komiteti". Në aspektin praktik çdo drejtues njësie (ndërmarrjeje, shkolle, institucioni, etj) nëse nuk ishte komunist, por ishte përzgjedhur prej tyre, raportonte periodikisht përpara organizatës bazë të partisë. Vendimet e organizatës ishin të formës së prerë dhe ato preknin të gjitha aspektet e organizimit të punës, politikat e emërimeve e transferimeve, të dënimit dhe të internimeve si dhe të masave të detajuara për zbatimin në kohë dhe me partishmëri të lartë të vendimeve të ardhura nga organet më të larta të partisë.

Në funksion të qëllimeve të veta politike PPSH mbajti në këmbë dhe forcoi rolin e organizatave fiktive, të njohura si leva të partisë. Gjatë periudhës së luftës vetë PKSH u prezantua gjithnjë në emër të Frontit Demokratik, organizatë që përmendet edhe në Statutin e vitit 1948. Fronti ishte një emërtim i pëlqyer për qytetarët që mendonin se regjimi i ri do të garantonte liritë individuale pavarësisht bindjeve politike dhe përkatësisë shoqërore. Kjo është edhe arsyeja që në të gjitha proceset zgjedhore të periudhës komuniste kandidimi në zgjedhje nuk është bërë në emër të PPSH-së, por në emër të Frontit Demokratik. Struktura të tjera të rëndësishme ishin: Bashkimi i Rinisë Komuniste, Bashkimi i Grave, Bashkimi i Veteranëve, Bashkimet Profesionale, organizata Pionieri, etj, të cilat në thelb ishin mekanizma propagandues dhe shtojca artificiale të të politikës së partisë-shtet. Roli dhe misioni i tyre del më qartë në nenin 21 të Kushtetutës së vitit 1950, sipas të cilit:[61] *"Për të zhvilluar iniciativën e masave punonjësve në fushën e organizimit dhe aktivitetin e tyre politik, shteti u siguron shtetasve të drejtën që të bashkohen në organizata shoqërore: Fronti Demokratik, bashkimet profesionale, kooperativat, organizatat e rinisë dhe të gruas, organizatat sportive dhe të mbrojtjes, shoqatat kulturore, teknike dhe shkencore; shtetasit më aktivë dhe më të ndërgjegjshëm të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjësve bashkohen me Partinë e Punës së Shqipërisë, pararoja e organizuar e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse në luftën e tyre për ndërtimin e bazave të socializmit dhe*

[61] *Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.*

bërthama udhëheqëse e të gjitha organizatave të punonjësve, si shoqërore, ashtu edhe shtetërore".

Anëtarësia në PPSH ishte privilegj politik dhe siguronte status social për personin dhe anëtarët e familjes së tij. Përjashtimi nga partia ishte masë po aq e ashpër sa dënimi penal, si për personin ashtu edhe për familjen e tij. Gjatë viteve anëtarësia e PPSH ka ndryshuar duke reflektuar zhvillimet politike në vend. Sipas të dhënave zyrtare në fundin e vitit 1946 PKSH kishte rreth 16 mijë anëtarë dhe kandidatë, nga të cilët, 7094 ose 44% e totalit të tyre ishin ushtarakë[62]. Fakti se dy vjet pas përfundimit të luftës gjysma e anëtarëve ishin ushtarakë është tregues i përdorimit të saj për zgjerimin e ndikimit të PKSH në shoqëri, sidomos në zona ku ajo nuk ishte e mirëpritur ose jo popullore.



Të dhënat e tjera të tabelës janë marrë nga raportimet zyrtare në Kongreset e PPSH 1948-1991. Praktika e punës ishte e tillë, që numri i

[62] *Kaba Hamit, Ethem Ceku. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962, IH/ASA, Tiranë 2017, f.55.*

anëtarëve dhe kandidatëve duhej të ishte në rritje të vazhdueshme për shkak të rritjes së numrit të popullësisë. Sic shihet nga tabela rendi i rritjes së popullsisë ka vijuar gjatë gjithë periudhës 1946-1990 të jetë në rritje nga 9% në 31%. Rënia e vitit 1991 lidhet me valën e emigrimit përpara mbajtjes së Kongresit të 10-të të PPSH. Nga ana tjetër kurba e anëtarësisë në PPSH ka pësuar rënie midis 1948-1952 kryesisht për shkak të fushatës së spastrimeve të brendshme, si dhe pas vitit 1961 ka vijuar të shënojë rënie të kurbës, për të njëjtën arsye. Në vitet e fundit të sistemit komunist regjistrimet e reja në PPSH kanë qenë në përqindje më të ulët kryesisht për shkak të rritjes së pakënaqësisë dhe krizës në rritje të besimit ndaj partisë – shtet.

Anëtarësia e PPSH pushoi në qershor 1991, kur në Kongresin e 10-të të saj, ajo ndryshoi emrin, programin, strukturën dhe rolin politik në një shoqëri tashmë pluraliste dhe konkurruese. Zyrtarisht sistemi njëpartiak i drejtuar nga PPSH mori fund me miratimin e Dispozitave Kushtetuese dhe abrogimin e Kushtetutës së vitit 1976, proces që ndodhi në prill 1991, përmes konsensusit politik në parlamentin e parë pluralist. Më 13 korrik 1992, vendimi i parë i Gjykatës së re Kushtetuese, institucion i krijuar për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, lidhej pikërisht me trashëgiminë e PPSH dhe pozitën e saj në kushtet e pluralizmit politik[63]. aty theksohej midis të tjerash: "*Vendimet e Kongreseve të*

---

[63] *Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese thuhet: "Gjykata Kushtetuese ka parasysh pozitën e veçantë determinuese dhe komanduese që zinte në jetën politike, ideologjike, ekonomike e sociale të vendit tonë Partia e Punës e Shqipërisë gjatë sundimit të saj diktatorial për afër gjysëm shekulli. Këtë karakter dhe pozitë të veçantë si parti-shtet ose si shtet mbi shtetin, kjo parti ia ka imponuar shoqërisë shqiptare edhe me forcën e kushtetutave të hartuara e të miratuara prej saj. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, e miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 14.3.1946, me ndryshimet e vitit 1950 (G.Z. nr.19/1946 dhe G.Z. nr.50/1950), në nenin 21 të saj, ndër të tjera, shpallte se Partia e Punës së Shqipërisë është "...bërthama udhëheqëse e të gjitha organizatave të punonjësve, si shoqërore ashtu edhe shtetërore", ndërsa Kushtetuta e RPSSH, miratuar me ligjin nr.5506, datë 28.12.1976, ndryshuar me ligjin nr.6799, datë 29.6.1983, në nenin 3, paragrafi i parë, shpallte se: "PPSH, pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike, udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë". Për më tepër, vendimet e Kongreseve të Partisë, të Byrosë Politike, të Komitetit të saj Qendror, deri edhe ato të organeve më të ulta të saj, të ashtuquajturat direktiva të*

Partisë, të Byrosë Politike, të Komitetit të saj Qendror, deri edhe ato të organeve më të ulta të saj, të ashtuquajturat direktiva të Partisë, ndonëse nuk cilësoheshin në mënyrë të shprehur si burime të së drejtës, qëndronin mbi Kushtetutën dhe ligjet, përbënin bazën e të gjithë veprimtarisë shtetërore e shoqërore në të gjitha fushat, kushtëzonin gjithë procesin e hartimit, miratimit, zbatimit dhe interpretimit të normave juridike. Për rrjedhojë, veprimtaritë e organit më të lartë ligjvënës, Kuvendit Populllor, e Presidiumit të tij dhe e organeve të tjera shtetërore, ktheheshin në një veprimtari konfirmuese formale'[64].

Përfundime

Shqipëria e viteve 1945-1990 përbën një rast unik edhe në listën e vendeve komuniste në Evropë për shkak të drejtimit të personalizuar, të dhunshëm dhe sistematik. I imponuar në fundin e Luftës II Botërore dhe i ndihmuar nga zhvillimet gjeopolitike të kohës, sistemi njëpartiak në Shqipëri kaloi në dy faza, - në ndjekjen besnike të modeleve imponuese nga fuqitë aleate (Jugosllavia, BRSS, Kina) dhe më pas, në ndjekjen e rrugës unike të vetizolimit të plotë. Kur në mesin e viteve '70 nisën

---

Partisë, ndonëse nuk cilësoheshin në mënyrë të shprehur si burime të së drejtës, qëndronin mbi Kushtetutën dhe ligjet, përbënin bazën e të gjithë veprimtarisë shtetërore e shoqërore në të gjitha fushat, kushtëzonin gjithë procesin e hartimit, miratimit, zbatimit dhe interpretimit të normave juridike. Për rrjedhojë, veprimtaritë e organit më të lartë ligjvënës, Kuvendit Populllor, e Presidiumit të tij dhe e organeve të tjera shtetërore, ktheheshin në një veprimtari konfirmuese formale. Për më tepër, fusha të gjera e të rëndësishme të veprimtarisë shtetërore, në mënyrë të veçantë veprimtaria e sektorëve të rëndësishëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Jashtme, të Mbrojtjes e të organeve të drejtësisë, rregulloheshin vetëm ose kryesisht me akte partiake dhe vartësia e tyre shtetërore ishte fiktive. Veprimtaria e tyre praktikisht nuk organizohej, drejtohej e kontrollohej në rrugë shtetërore. Në këto kushte, një numër i konsiderueshëm vendimesh, direktivash e aktesh të tjera, të miratuara nga organet partiake, por që rregullonin veprimtarinë shtetërore, nuk komunikoheshin fare në rrugë shtetërore. Këto dokumente të shumta që pasqyrojnë veprimtarinë shtetërore të partisë-shtet, përbëjnë materiale me vlera të përgjithshme për fondin arkivor të shtetit dhe duhet t'i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, në zbatim të neneve 1, 2 të ligjit nr.6893, datë 19.6.1984 "Për fondin arkivor të shtetit dhe për arkivat"'.

[64] *Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.1, 13.07.1992.*

reformat në disa prej vendeve ish-komuniste, regjimi komunist në Shqipëri thelloi sistemin e saj të dhunës dhe kontrollit të plotë mbi shtetin e shoqërinë. Legjitimiteti sundues dhe ideologjik i ligjëruar në Kushtetutat e viteve 1946 dhe 1976 nuk u testua përmes vullnetit real të qytetarëve, megjithatë ai ofron elementë të shumtë të tipareve të veçanta të tij, si dhe rrugën specifike që ndoqi Shqipëria komuniste.

Duke krijuar një sistem të centralizuar dhe të personalizuar pushteti, ku udhëheqësi komunist Hoxha dhe Byroja Politika ishin pushteti i vetëm real dhe fuqia reale vendimmarrëse, institucionet kushtetuese dështuan të funksionojnë, të luajnë rol në zhvillimet politike dhe të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore. Kuvendi Popullor, pushteti ekzekutiv dhe sistemi gjyqësor, organet e sigurisë dhe të mbrojtjes, institucionet financiare dhe ato kulturore, etj, ishin formale dhe urdhër-zbatuese të Byrosë Politike në të gjithë aktivitetin e tyre. Krahas kulturës së dhunshme kundër konceptit të të drejtave të njeriut, investimi i PPSH kundër konceptit të institucioneve dhe për pasojë, kundër koncepteve të shtetit dhe ligjit, janë dy aktet më me pasoja afatgjata në kulturën politike dhe në trashëgiminë e 46 viteve të sistemit parti-shtet.

Punimi analizon tiparet e Kushtetutave 1946 dhe 1976, tiparet e përfaqësimit formal politik, kurbën e raporteve midis PPSH dhe shtetit, rolin e elitave politike, të institucioneve të tjera dhe strukturën e funksionimit të partisë – shtet, duke tentuar të pasqyrojë një këndvështrim plotësues në një analizë profesionale mbi shtetin e shoqërinë shqiptare 1946-1990. Të dhënat e sjella ilustruese janë përzgjedhur për të argumentuar tezat e punimit dhe faktin se në disa aspekte të rëndësishme, sidomos në kulturën institucionale dhe kulturën e përfaqësimit, shoqëria shqiptare vijon të jetë e ndikuar nga trashëgimia negative e të kaluarës.

Literatura e përdorur

Akademia e Shkencave. Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985.
Arkivi i legjislacionit në "Gazeta Zyrtare", 1945-1990.
Arkivi Shtetëror. Fondi 14 AP/OU dhe arkivi i QBZ-së
Della Rocca, Roberto Marozzo. Shqipëria, rrënjët e krizës, Tiranë 2000.
Drejtoria e Përgjithshme e Statistikave. 30 vjet Shqipëri Socialiste, Kuvendi Popullor, 1974.
Hensell, Stephan. Regieren in Albanien. WeltTrends Nr 45. Hamburg. 2004.
Kaba Hamit, Ethem Ceku. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946-1962, IH/ASA, Tiranë 2017.
Kadare, Ismail. Nga një dhjetor në tjetrin, Fayard, Paris, 1991.
Krasniqi, Afrim. Partitë politike në Shqipëri, ISP, Tiranë 2006.
Krasniqi, Afrim. Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.
Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.
Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946.
Meta, Beqir; Afrim Krasniqi, Hasan Bello: "Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit", Dokumente Historike, Vëllimi II, 1968-1973, IH/ASA, 2019.
Ngjela, Spartak. Përkulja dhe Rënia e Tiranisë Shqiptare, 1957-2010, UET, Press, Tiranë, 2011
Omari, Luan. Sistemi parlamentar. Parlamenti në Shqipëri. Tiranë, 2004.
Pipa, Arshi. Stalinizmi shqiptar: aspekte ideopolitike, Princi, Tiranë 2010.
Xhafa, Luan. Libri i zi i komunizmit, kapitulli "Shqipëria", Besa, Tiranë, 2000.